




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Në mbështetje të nenit 11 nenit 12 paragrafi 1 dhe 2, shkronja d), neni 52 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 53 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, neni 3 paragrafi 2, neni 4 dhe 5 neni 6 paragrafi 4 neni 12 paragrafi 1, i Udhëzimit Administrativ Nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, ndërlidhur me nenin 13 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 i Rregullores (MAPL) Nr.02/2015 Për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunave, duke u bazuar në rekomandimin e MAPL-së Nr.020-10/18, të datës 13.02.2026, dhe neni 14 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), i Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 i datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës ne mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën; 07.04.2026, mori këtë:

**V E N D I M**

(Për rishqyrtimin e Vendimit Nr. 01-020/01-0008208/26 i datës; 03.02.2026, për formimin e komitetit për politik dhe financa )

**Neni 1**

Miratohet propozim-vendimi Nr. 01-020/01-0011515/26, i datës, 31.03.2026, Për rishqyrtimin e Vendimit Nr. 01-020/01-0008208/26 i datës; 03.02.2026, përkitazi me procedurën e formimit të komitetit për politik dhe financa.

**Neni 2**

Anëtari i Komitetit për Politikë dhe Financa **z.Dardan Shala**, nga subjekti politik (PDK), **Zëvendësohet** me anëtarën **znj. Arlinda Haliti**, nga i njëjti subjekt Politik (PDK) duke plotësuar përfaqësimin gjinor, bazuar në rekomandimin e MAPL-së Nr.020-10/12, të datës; 27.03.2026.

**Neni 2**

Mandati i anëtares të zëvendësuar është i njëjtë me mandat te Kuvendit te Komunës.

**Neni 3**

Neni 1 pika 4 i vendimit bazë Nr. 01-020.01-0000460/26 i datës; 05.01.2026, ndryshohet plotësohet, ndërsa pjesa tjetër mbetet ne fuqi dhe të pa ndryshuara, si dhe vendimi Nr. 01-020/01-0008208/26, i datës; 03.03.2026, mbetet ne fuqi.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi, 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit te tij ne ueb – faqen të Komunës.

**Vendimi i Dërgohet :**

- 1x1 Anëtarëve të zëvendësuar,
- 1x1 MAPL-së,
- 1x1 Zyrës së Kryetarit,
- 1x1 Arkivit,
- 1x1 Dosjes.

**KRYESUESJA E KUVENDIT**  
znj. Adolina Spahiu-Çalija



KOSOVË - IZLAZNA - OUTGOING  
 REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
 QEVERIA - VLADA / GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
 Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracion  
 Ministry of Local Government Administration

Nr. 020-10/14  
 -VI-  
 Data 04.05.2026  
 Organi  
 Datë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
 Ministry of Local Government Administration

Për:	Sami Lushtaku, Kryetar i Komunës së Skenderajt Adelina Spahiu-Alija, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erbllin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor MAPL	Datë: 20.04.2026 VI-020-10/13
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit Donjeta Cakolli, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,  
 E nderuar Kryesuese,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimi Nr.01-020/01-0012190/26 për rishqyrtimin e vendimit Nr.01-202/01-0008208 të datës 03.02.2026 për formimin e komitetit për politike dhe financa
I miratuar më datë: 07.04.2025
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 08.04.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

## ARSYETIM

Kuvendi i Komunës së Skenderajt në mbledhjen e mbajtur me datë 07.04.2026, ka miratuar, vendimin Nr.01-020/01-0012190/26 për rishqyrtimin e vendimit Nr.01-202/01-0008208 të datës 03.02.2026 për formimin e komitetit për politike dhe financa.

MAPL, konstaton se akti i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Skenderajt, është i bazuar në nenin 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenin 51 dhe nenin 52 të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 3, 4, 5, të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurën e Themelimit Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë.

Vendimi është miratuar me 21 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.